



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-04

Prokurori kundër Pjetër Shalës

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 3 shtator 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim mbi Kërkesën e ZPS-së për Tejkalimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Pjetër Shalës

Zhan-Lui Zhilisen

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të nenit 39(1) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”), rregullës 97 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), dhe neneve 36(1) dhe (2) dhe 42 të Udhëzuesit të Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara (“Udhëzuesi i Punës”),² nxjerr këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 19 qershor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për konfirmimin e aktakuzës,³ Prokurori i Specializuar paraqiti Aktakuzën e Konfirmuar.⁴
2. Më 16 mars 2021, Pjetër Shala (“z. Shala”) u arrestua në Mbretërinë e Belgjikës (“Belgjika”).⁵
3. Më 15 prill 2021, me përfundimin e procedurave gjyqësore në Belgjikë, z. Shala u transferua në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara (“DHS”) në Hagë, Holandë.⁶

¹ KSC-BC-2020-04, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 14 shkurt 2020, publik.

² Udhëzuesi i Punës i Zyrës Administrative për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës (KSC-BD-15), 17 maj 2019.

³ KSC-BC-2020-04, F00007, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Pjetër Shalës*, 12 qershor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 6 maj 2021, F00007/RED.

⁴ KSC-BC-2020-04, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 19 qershor 2020, publik, me shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe shtojcën 2, konfidenciale. Versioni publik me më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 31 mars 2021, F00016/A02.

⁵ KSC-BC-2020-04, F00013, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit sipas Rregullës 55(4)*, 16 mars 2021, publik.

⁶ KSC-BC-2020-04, F00019/RED, Administratorja, *Version i Redaktuar Publik i “Njoftimit për Pranimin e Pjetër Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe për Caktimin me Kusht të Mbrojtësit”, parashtrimi F00019 që mban datën 15 prill 2021, 26 prill 2021, publik, me shtojcat 1-2, konfidenciale.*

4. Më 12 korrik 2021, në vijim të një urdhri me gojë të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,⁷ Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja") dorëzoi një mocion paraprak me anë të cilit kundërshton juridiksionin e DHS-së ("Mocioni mbi Juridiksionin").⁸ Gjithashtu, më 13 korrik 2021,⁹ Mbrojtja dorëzoi një mocion paraprak për mangësi në formën e Aktakuzës së Konfirmuar ("Mocioni mbi Aktakuzën")

5. Më 1 shtator 2021, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS"), në bazë të nenit 36 të Udhëzuesit të Punës, dorëzoi një kërkesë për tejkallim të numrit të lejuar të fjalëve për përgjigjet e saj të pritshme ndaj Mocionit mbi Juridiksionin dhe Mocionit mbi Aktakuzën ("Përgjigjja" ose "Përgjigjet") përkatësisht deri në 15000 dhe 12000 fjalë ("Kërkesa").¹⁰ Sipas ZPS-së, nevojiten parashtrime të hollësishme dhe të gjata pasi Mocioni mbi Juridiksionin dhe Mocioni mbi Aktakuzën janë afër kufirit të numrit të lejuar të fjalëve dhe Mbrojtja mbështet parashtrimet e ekipeve të Mbrojtjes në çështjet e tjera gjyqësore.¹¹ ZPS-ja shton se Mbrojtjes nuk do t'i shkaktohej dëm, pasi ajo do të ketë mundësinë të kundërpërgjigjet në lidhje me të gjitha çështjet e reja që mund të dalin nga Përgjigjet.¹²

II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Sipas rregullës 97(1) të Rregullores, i akuzuari mund të paraqesë mocione paraprake, të cilat nuk njohin juridiksionin e DHS-së, pretendojnë mangësi në formën e aktakuzës dhe kërkojnë veçimin e akuzave sipas rregullës 89(2) të Rregullores.

⁷ KSC-BC-2020-04, Transkripti, 21 qershor 2021, f. 62, rreshtat 12-19, publik.

⁸ KSC-BC-2020-04, F00054, Mbrojtja e Specializuar, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Pjetër Shalës që Kundërshton Juridiksionin e DHSK-së*, 12 korrik 2021, publik.

⁹ KSC-BC-2020-04, F00055, Mbrojtja e Specializuar, *Mocion Paraprak i Mbrojtjes së Pjetër Shalës për Mangësi në Formën e Aktakuzës*, 13 korrik 2021, konfidencial. Versioni i korrigjuar u dorëzua më 15 korrik 2021, F00055/COR.

¹⁰ KSC-BC-2020-04, F00063, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë e Prokurorisë për Tejkallimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Përgjigjet ndaj Mocioneve Paraprake*, 1 shtator 2021, konfidenciale, para. 3.

¹¹ Kërkesa, para. 2.

¹² Kërkesa, para. 3.

7. Sipas nenit 36(1) të Udhëzuesit të Punës, një pjesëmarrës në proces mund t'i kërkojë leje panelit paraprakisht mjaftueshëm në kohë për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve, nëse tregon se ka arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të posaçme.
8. Sipas nenit 36(2) të Udhëzuesit të Punës, në qoftë se nuk i shkaktohet dëm palës kundërshtare ose mbrojtësit të viktimave, mocioni për tejkalimin e numrit të lejuar të fjalëve mund të miratohet pa i dhënë atyre mundësinë për t'u shprehur në lidhje me mocionin.
9. Sipas nenit 42 të Udhëzuesit të Punës, mocionet paraprake dhe përgjigjet ndaj tyre të parashtruara sipas rregullës 97 të Rregullores nuk duhet të jenë më shumë se 9000 fjalë. Kundërpërgjigjet ndaj këtyre përgjigjeve nuk duhet të jenë më shumë se 3000 fjalë.

III. DISKUTIM

A. KËRKESA

10. Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se është provuar se ekzistojnë arsye të vlefshme të cilat përbëjnë rrethana të posaçme që përlligjin ndryshimin e numrit të lejuar të fjalëve për Përgjigjet, duke pasur parasysh numrin dhe rëndësinë e çështjeve të cilave ZPS-ja synon t'u përgjigjet. Gjithashtu, Kërkesa është dorëzuar paraprakisht mjaftueshëm në kohë, përkatësisht pesë ditë para afatit kohor për dorëzimin e Përgjigjeve. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake autorizon ZPS-në të dorëzojë një Përgjigje me jo më shumë se 15000 fjalë ndaj Mocionit mbi Juridiksionin dhe një Përgjigje me jo më shumë se 12000 fjalë ndaj Mocionit mbi Aktakuzën.
11. Duke marrë parasysh se ndryshimi i kërkuar është mjaft i kufizuar dhe duke vënë në dukje afatin e afërt për dorëzimin e Përgjigjeve, nxjerrja e këtij vendimi përpara marrjes së përgjigjes së Mbrojtjes ndaj Kërkesës, në përputhje me nenin 36(2) të Udhëzuesit të Punës, nuk i shkakton dëm Mbrojtjes.

B. KLASIFIKIMI

12. ZPS-ja ka vënë në dukje se nuk e kundërshton riklasifikimin e Kërkesës si publike.¹³ Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Administratoren të riklasifikojë Kërkesën si publike, në përputhje me rregullën 82(5) të Rregullores.

13. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se Mbrojtja ka vënë në dukje se do të dorëzojë në kohën e duhur versionin e redaktuar publik të Mocionit mbi Aktakuzën.¹⁴ Me qëllim të ruajtjes së parimit të procesit publik¹⁵ dhe nxjerrjes së një vendimi publik, Gjykatësi i Procedurës Paraprake urdhëron Mbrojtjen të dorëzojë një version të redaktuar publik të Mocionit mbi Aktakuzën jo më vonë se të premtën, 10 shtator 2021.

IV. VENDIM

14. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- (a) **MIRATON** Kërkesën;
- (b) **URDHËRON** Administratoren të riklasifikojë Kërkesën si publike; dhe
- (c) **URDHËRON** Mbrojtjen të dorëzojë një version të redaktuar publik të Mocionit mbi Aktakuzën jo më vonë se **të premtën, 10 shtator 2021.**

/nënshkrimi/

Gjykatës Nikola Giju

Gjykatësi i Procedurës Paraprake

E premtë, 3 shtator 2021

Në Hagë, Holandë.

¹³ Kërkesa, poshtëshënimi 1.

¹⁴ Mocioni mbi Aktakuzën, para. 4.

¹⁵ Neni 21(2) i Ligjit.